



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË MBETJEVE

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues M. I. E Nr. Prot. 5760 Data 27.07.22

Shkurtimi i lëndës Marteshja krijimi Ujësjellës Regional Fier

Për trajtim nga: (Struktura të tjera të ngarkuara)	<u>Z. Demi, Zoi Kuba</u>
Me porosi:	

Afati: Normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (brenda dites) Pa afat/për ditë

Tjetër _____ ditë

Data 27.07.22 Nr. Prot. 1622

Nënshkrimi: TITULLARI

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi: _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfundimtar më _____ Specialisti
Trajtimi i materialit përfundimtar më _____ Eprori në shkallë hierarkike
Trajtimi i materialit përfundimtar më _____ Eprori në shkallë hierarkike
Trajtimi i materialit përfundimtar më _____ Eprori në shkallë hierarkike

Nr. 6407

Dt. 26.07.2022



Nr. 6976

Dato: 26.07.22



Nr. 3800
Dt. 20.07.2022



Nr. 1808 Prot

Dt. 26.07.2022



5760 prot. MIE

27.7.2022



MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE

Kjo marrëveshje lidhet sot më datë 22.07.2022 ndërmjet:

Bashkisë Fier, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Armando Subashi,

Bashkisë Patos, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Znj. Rajmonda Balilaj,

Bashkisë Mallakastër, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Qcrim Ismailaj,

Bashkisë Roskovec, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Znj. Majlinda Bufi

dhe

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (këtu e më poshtë referuar si MIE) përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Znj. Belinda Balluku,

këtej e tutje referuar të gjitha si "Palët".

Meqënëse:

- Duke pasur parasysh reformën e ndërmarrë për përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe të shërbimit të konsumatorëve;
- Duke qenë të ndërgjegjshëm për nevojën e përmirësimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe grumbullimin e trajtimin e ujrave të ndotura urbane;
- Duke marrë në konsideratë faktin që shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve të Bashkisë Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec vazhdojnë të kenë nevojë për mbështetjen e autoriteteve qendrore për përmirësimin e administrimit të aseteve të saj, shëndoshjen e gjendjes së saj financiare dhe sigurimin e burimeve të financimit për investimet e nevojshme në zonat e tyre të shërbimit;
- Në mbështetje të VKM Nr.302 datë 11.05.2022 që autorizon MIE për hyrjen në një marrëveshje specifike me Bashkitë Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkisë Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec;

- Në mbështetje të Vendimit Nr. 57 datë 08.06.2022 të Këshillit Bashkiak Fier, të Vendimit Nr. 40 datë 20.06.2022 të Këshillit Bashkiak Patos, Vendimit Nr. 36 datë 20.06.2022 të Këshillit Bashkiak Mallakastër dhe Vendimit Nr. 40 datë 29.06.2022 të Këshillit Bashkiak Roskovec, që autorizojnë Kryetarët e Bashkive Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec të hyjnë në një marrëveshje specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec;

Palët bien dakort të hyjnë në një marrëveshje me kushtet dhe termat e mëposhtëm:

Neni 1 Baza Ligjore

1. Kjo marrëveshje lidhet në përputhje me:
 - a) Dispozitat e pikës 5 të nenit 14 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar;
 - b) Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar;
 - c) Ligjin Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”;
 - d) VKM-në Nr. 302 datë 11.05.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Neni 2 Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka si qëllim krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës - Kanalizimeve (SKP-UK), i cili do të kryejë veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec të cilat janë palë e kësaj marrëveshjeje, pjesë e të cilës është edhe AKUM.

Neni 3 Forma dhe emri i Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta

1. Palët bien dakort që Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës Kanalizimeve do të jetë një shoqëri aksionare e krijuar SKP-UK, tek e cila do të transferohet tërësisht veprimtaria ekonomike e shoqërive ekzistuese të ujësjiellës-kanalizimeve të cilat aktualisht janë në pronësi të Bashkive Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec.

2. Emri i Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta i krijuar sipas kësaj marrëveshje do të jetë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.
3. Shoqëria aksionare e krijuar sipas kësaj marrëveshje do të administrohet me dy nivele administrimi. Organet drejtuese të shoqërisë do të krijohen dhe kompozohen sipas dispozitave të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar.
4. Shoqëria do të ketë si statut të saj statutin tip të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4 Objekti i SKPUK

1. Objekti i SKPUK-së është kryerja e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territoret administrative të Bashkive Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec në përputhje me legjislacionin e sektorit të furnizimit me ujë.
2. Shoqëria e re e krijuar mund të ngarkohet me detyrimin e mbledhjes së një ose më shumë taksave vendore për llogari të bashkive palë në këtë marrëveshje, nëse kjo kërkohet prej tyre.

Neni 5 Afati i SKPUK

Palët bien dakort që SKPUK i krijuar sipas kësaj marrëveshje të krijohet për një periudhë të pacaktuar.

Neni 6 Kontributi i Palëve

1. Kapitali fillestar për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a, është në masën 10.000.000 lekë. Në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901 datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me qëllim themelimin dhe regjistrimin e shoqërive të reja SKP-UK, MIE do të likujdojë vlerën e 51% të aksioneve që do të përfitojnë.
2. Pjesëmarrja në përqindje në asamblenë e aksionerëve në shoqërinë e re ujësjellës-kanalizime (SKPUK) e Bashkive Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec në pronësi të të cilave janë aktualisht shoqëritë ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve është përlllogaritur në përpjesëtim me numrin e abonentëve aktive që këto shoqëri kanë duke përfshirë edhe kontratat aktive aktuale që administrohen nga vetë Bashkitë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKPUK, vlera totale e të cilave do të përbëjë 49% të aksioneve të shoqërisë së re, dhe përbëhet në përqindje si vijon: Bashkia Fier 33.99%, Bashkia Patos 5.21%, Bashkia Mallakastër 5.49% dhe Bashkia Roskovec 4.31%.

3. Pas themelimit të shoqërisë së re SKP-UK, Bashkitë Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec do të transferojnë tek SKP-UK të gjithë veprimtarinë e shoqërive të UK, që kryejnë aktualisht veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në territoret administrative respektive në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
4. Në Bashkitë Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, brenda datës 31 dhjetor 2022, janë përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe transferimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.
5. Pasi procesi i transferimit të ketë përfunduar, përcaktimi i vlerës nominale të 51% të aksioneve që do të zotërohen nga MIE, në Shoqërinë Rajonale UK Fier sh.a do të realizohet pasi vlera e saktë e aksioneve të përfituara të përcaktohen në bazë të raportit që do të hartohet nga eksperti kontabël që do të caktohet gjatë procedurave të transferimit.
6. Aksionarët do të nënshkruajnë kontratë rritje kapitali që investimet e ardhshme dhe fitimi të kapitalizohen dhe të alokohen derisa të arrijnë përqindjen sipas kësaj marrëveshje.
7. Shlyerja e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE do të kryhet duke njohur investimet në proces të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit dhe me anë të investimeve kapitale që qeveria do të ndërmarrë në vitet në vijim në Shoqërinë Rajonale UK Fier sh.a.
8. Në rastet kur vlera e investimit të parashikuar dhe marrë tashmë përsipër nga qeveria qendrore dhe të pasqyruar në tavanet buxhetore do të kalojë vlerën nominale të 51% të aksioneve, pasqyrimi i vlerës së tepricës nuk ndryshon masën e pjesëmarrjes në aksione të Shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a.
9. Gjithashtu, si instrument për shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE, do të konsiderohet edhe shuarja me kompensim e vlerës së detyrimeve që UK Fier sh.a, UK Patos sh.a, UK Mallakastër sh.a dhe UK Roskovec sh.a kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKP-UK, ndaj institucioneve qendrore buxhetore dhe jo buxhetore, deri në masën e pagimit të plotë të 51% të aksioneve të shoqërisë së re.

Neni 7

Procedurat e Transferimit

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive UK Fier sh.a, UK Patos sh.a, UK Mallakastër sh.a dhe UK Roskovec sh.a me propozimin dhe mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), do të caktojnë ekspertë të pavarur për të vlerësuar dhe asistuar në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, gjatë procedurave të transferimit të veprimtarisë për tek shoqëria e re SKP-UK.

2. Bilanci i transferimit të konsiderohet bilanci i datës 31.12.2021.
3. Data e transferimit efektiv, në të cilën aktivitetet do të konsiderohen të kryera nga Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a do të jetë dita e 45-të nga njoftimi i Drejtorive Tatimore.
4. Veprimtaritë e UK në periudhën nga data e bilancit të transferimit deri në datën e transferimit efektiv do të sjellë si pasojë ndryshimin e balancave të transferimit, të cilat do të rregullohen me efekt në tepricën e transferimit që do të njihet. Pasqyrat financiare do të hartohen në datën e transferimit efektiv dhe për këtë mund të përgatitet një raport i posacëm për të identifikuar diferencat dhe rregullimin e tyre.
5. Të gjitha shpenzimet e nevojshme për kryerjen e procedurës së themelimit të Shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a, shpenzimet e nevojshme për caktimin e ekspertëve si dhe shpenzimeve të transferimit të plotë të veprimtarisë tek shoqëria e re SKP-UK do të përballohen nga buxheti i shtetit. Vlera e shpenzimeve të mësipërme si dhe vlera e shpenzimeve fillestare që do t'i akordohet Shoqërisë Rajonale UK Fier sh.a do të përlllogaritet si kontribut në shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve të përftuara nga MIE.
6. Shpenzimet për likuidimin e shoqërive transferuese do të përballohen nga shoqëria e re SKP-UK.

Neni 8

Prishja e marrëveshjes në mënyrë të njëanshme

1. Asnjë nga palët nuk mund të prishë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme pa kaluar 10 vjet nga krijimi i SKPUK-së.
2. Pas kalimit të afatit 10-vjeçar të përcaktuar në pikën 1, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në çdo kohë mund të vendosë tërheqjen e njëanshme nga kjo marrëveshje duke i transferuar aksionet e saj në shoqërinë e krijuar sipas kësaj marrëveshje tek Bashkitë Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec proporcionalisht me përqindjen e aksioneve të tyre në shoqëri.
3. Nëse një nga Bashkitë Fier, Patos, Mallakastër dhe Roskovec kërkon prishjen e njëanshme të kësaj marrëveshje pas kalimit të afatit 10-vjeçar, bashkia duhet të ndërmmarrë hapat e kërkuara në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar.
4. Nëse një nga bashkitë vendos të prishë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen, sipas pikës "3", ajo është e detyruar që për vitin buxhetor pasardhës të mbulojë të gjitha investimet apo detyrimet e tjera financiare përfshirë masat e miratuara në biznesplanin e shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që do të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, palët do të përpiqen ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt secila nga palët mund t'i drejtohet për zgjidhjen e saj Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 10
Të tjera

Gjatë gjithë periudhës tranzitore të transferimit, Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve do të pezullojnë të gjitha planet e investimeve dhe procedurat e prokurimit që kanë aktualisht në proces, përveç mirëmbajtjeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e Prefektit/Prefektëve sipas kërkesave të nenit 14 të Ligjit Nr. 179/2010 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

1. Kryetari i Bashkisë Fier

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

2. Kryetari i Bashkisë Patos

3. Kryetari i Bashkisë Mallakastër

4. Kryetari i Bashkisë Roskovec

The document features several official signatures and blue circular stamps. The stamps are from the Republic of Albania (REPUBLIKA E SHQIPËRIE) and the municipalities of Fier, Patos, Mallakastër, and Roskovec. There is also a stamp from the Ministry of Infrastructure and Energy (MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË). The signatures are handwritten in blue ink over the stamps.